



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 18/08/2025

PROCES VERBAL

Konsultimi për Strategjinë e Planit të Veprimit të Turizmit 2025-2030

Vendi : Zyra e Kryetarit të Bashkisë, Përmet

Ora : 11:00

Tema e konsultimit : Strategjia e Planit të Veprimit të Turizmit 2025-2030

I mbajtur sot më datë 18 Gusht në zyrën e Kryetarit të Bashkisë ku të pranishëm janë grupi i punës sipas Urdhrit të Kryetarit Nr. 265 Datë 14.07.2025. Ky takim u zhvillua me qëllim njohjen e Grupit të punës me Draft Planin I cili u hartua nga Bashkia Përmet në bashkëpunim me ekspertë pjesë të Ministrisë së Turizmit të cilët po zbatojnë në Bashkinë Përmet një project së bashku me një OJF lokale.

Takimin e hapi Nënryetarja e Bashkisë Përmet e cila bëri një prezantim të përgjithshëm të Draft Planit, i cili bazohet në Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2024-2030. Duke marrë parasysh që turizmi këto vitet e fundit është kthyer në bazën e ekonomisë për qytetin tonë, dhe si i tillë ky dokument është tepër i rëndësishëm për të arritur në një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit për vitet në vijim duke shfrytëzuar cdo potencial që Përmeti zotëron në favor të zhvillimit turistik.

Ky draft i hartuar ka elementë që i përkasin sektorëve të Bashkisë dhe si i tillë duhet kompletuar më të gjithë elementët e nevojshëm përpara se të publikohet për komunitetin në dëgjuesën që do të mbahet ditët e ardhshme. Pra Grupet e punës do të përditësojnë informacionin dhe të dhënat e munguara sasiore dhe cilësore. Planet janë dokumenta të rëndësishme prej të cilave matet edhe performance e institucionit si dhe një kriter i rëndësishëm për procesin e integritetit dhe rolin që bashkitë kanë në këtë proces.

Komiteti i Veprimit të Turizmit si pjesë e shtojcës 1 të Draft Planit u sqarua nga Nenkryetarja si grupi kryesor i caktuar përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e Planit në vazhdimësi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Diskutimi vijoi me 4 objektivat e përcaktuar të Planit të cilat përkthehen në aktivitete për arritjen e synimeve. Objektivat realizohen nëpërmjet thirrjeve nga donatorë të ndryshëm por edhe bashkëpunim të aktorëve dhe faktorëve vendor, OJF dhe planifikimet buxhetore të bashkisë.

Një element për diskutim dhe që ka nevojë për sugjerime nga secili prej sektorëve është Analiza e Konkurencës në zonat kufitare si dhe Analiza SWOT për të dalluar pikat e forta dhe të dobëta. Gjithashtu do të bëhet rishikim nëse janë përfshirë të gjitha objektet turistike.

Cdo sugjerim dhe ide nga Grupi i Punës duhet dërguar brenda kësaj jave me qëllim reflektimin e tyre në Plan, përpara konsultimit me aktorë të ndryshëm si biznese, operatorë turistikë, qytetarë etj.

Takimi u mbyll në orën **11:45**.

Konceptoi: Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK



Foto nga takimi:

